

VENDIM
Nr.126, datë 2.2.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË KOMUNËS POGON, TË QARKUT TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Pogon, të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ të komunës Pogon të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.764, datë 28.5.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Pogon të qarkut të Gjirokastrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Pogon për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Pogon

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-8	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
9-10	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
11-29, 31-100	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
101-206	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
207-280	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
281-283	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
626	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shërbimit social	Në pronësi
627-635	Varrezat publike	Në pronësi
636	Prona që përdoren për realizimin e	Në pronësi

	funksioneve në fushën e mbrojtjes civile	
637,638,640,642,644,646,647,649,650,652,653	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
639,641,643,645,648,651,654,655-658 (vetëm kanalet e treta)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka jo produktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
675-689	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi